



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
SEKRETARIA**

Nr. _____ Prot

Tiranë, më _____.____.2020

Njoftim

Për mbledhjen Nr. 4, datë 23.01.2020 të Bordit të ERE-s.

Në zbatim të (i) nenit 13 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; te ndryshuar, (ii) Rregullores bazë së Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë të miratuar me Vendimin e ERE-s Nr. 144/2019 dhe (iii) nenit 11 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s” miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr.96, datë.16.07.2016, njoftojmë se **ditën e Enjte, datë 23.01.2020, ora 09:30** në sallën e Mbledhjeve të ERE-s do të zhvillohet mbledhja nr. 4 e Bordit të ERE-s sipas këtij rendi dite:

- 1-** Mbi kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi
- 2-** Mbi kërkesën e shoqatës AAES për rishikimin e Vendimit të Bordit të ERE Nr.214 ,datë 20.12.2019 “ Për një ndryshim në “Rregulloren për procedurat e blerjes së energjisë elektrike për mbulimin e humbjeve në rrjetet e shpërndarjes dhe të transmetimit dhe për blerjen e energjisë elektrike për të siguruar përmbushjen e detyrimeve të shërbimit publik “
- 3-** Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së Sekretariatit të Energjisë në lidhje me shtimin e shtojcës në “Rregullat e përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, të miratuara me vendimin e Bordit nr. 193, datë 24.11.2017
- 4-** Mbi kërkesën e shoqërisë "Albpetrol" sh.a. për licencim në veprimtarinë e furnizimit të gazit natyror
- 5-** Mbi kërkesën për modifikimin e licencës së shoqërisë “Hec Bishnica 1,2” sh.p.k., nr. 95, seria pv10k, dhënë me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.23, datë 23.03.2010, për prodhimin e energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar
- 6-** Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Era Hydro” sh.p.k, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Strori” me kapacitet të instaluar 2000 kw
- 7-** Mbi licencimin e shoqërisë “Diezela” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hec “Ljusa” me kapacitet të instaluar 1980 kw.

KRYETARI

Petrit AHMETI